

Kërkesë për Ofertë: Prodhimi i një Video Dokumentari mbi Migracionin e Paligjshëm, në kuadër të Programit “Alternative Pathways”

1. Këshilli Britanik në Shqipëri po zbaton Programin Alternative Pathways, një projekt i financuar nga Zyra e Jashtme, e Komonuelthit dhe Zhvillimit, që angazhohet me të rinjtë në pikat e nxehta të migracionit në veri të Shqipërisë, duke u ofruar atyre alternativa ndaj migracionit të parregullt.

Në kuadër të Programit Alternative Pathways, Këshilli Britanik Shqipëri synon të prodhojë një video dokumentar profesional me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit dhe përmirësimit të cilësisë së informacionit mbi kompleksitetin dhe natyrën e shumëfishtë të migracionit të paligjshëm, shkaqet dhe pasojat e tij. Duke theksuar implikimet socio-ekonomike, kulturore dhe politike, ne kërkojmë të kundërshtojmë keqkuptimet dhe narrativat dezinformuese ekzistuese mbi këtë temë. Projekti synon të zbulojë dhe të rrëfejë realitetet me të cilat përballen migrantët, duke vënë në pah vështirësitë e tyre dhe ndikimin mbi familjet dhe komunitetet e tyre, me fokus të veçantë në veriun e Shqipërisë.

- 1.1 Qëllimi dhe fusha e tenderit dhe *Kërkesës për Ofertë* (RFP) sipas edhe dokumenteve mbështetëse me detajet dhe kërkesat e Këshillit Britanik dhe procesin për paraqitjen e një Oferte në përgjigje të kësaj *Kërkesë për Ofertë* (“Ofertë”).

2. Kushtet e Ofertës dhe Kërkesës për Ofertë

Ky seksion i **Kërkesës për Ofertë** përshkruan kërkesat kontraktuale të Këshillit Britanik, kërkesat e përgjithshme të politikave dhe kushtet e përgjithshme që lidhen me këtë proces prokurimi (“**Procesi i Prokurimit**”).

2.1 Kërkesat Kontraktuale

2.1.1 Autoriteti kontraktues: Këshilli Britanik, që përfshin çdo kompani dhe organizatë tjetër që kontrollon ose kontrollohet nga Këshilli Britanik herë pas herë (shiko: <http://www.britishcouncil.org/organisation/structure/status>).

2.1.2 Vendi i dorëzimit të mallrave dhe/ose shërbimeve: **zyrat e Këshillit Britanik në SHQIPËRI, RR. Sami Frashëri, Pall. TeknoProjekt, Hyrja 2, Ap.3, Tiranë, Shqipëri.**

2.1.3 Kohëzgjatja: maksimumi deri në **6 muaj**, duke filluar nga **Shtatori 2024**.

2.1.4 Termet kontraktuale: Duke paraqitur një **Ofertë**, ju konfirmoni se ju dhe të gjithë anëtarët e konsorciumit dhe/ose nënkontraktorët tuaj do të respektojnë të gjitha ligjet e zbatueshme, kodet e praktikës, udhëzimet ligjore dhe politikat e zbatueshme të Këshillit Britanik që janë të rëndësishme për mallrat dhe/ose shërbimet që po ofrohen. Të gjitha politikat përkatëse të Këshillit Britanik që pritet të respektohen nga furnizuesit mund të gjenden në faqen e internetit të British Council <https://www.britishcouncil.org/organisation/transparency/policies>).

2.2 Kërkesat e Përgjithshme të Politikës

2.2.1 Duke paraqitur një Ofertë, ju konfirmoni se ju dhe çdo anëtar i konsorciumit dhe/ose nënkontraktori do të respektoni të gjitha ligjet e zbatueshme, kodeve të praktikës, udhëzimeve ligjore dhe politikave të zbatueshme të Këshillit Britanik që lidhen me mallrat dhe/ose shërbimet që

po furnizohen. Të gjitha politikat e zbatueshme të Këshillit Britanik që pritet që furnizuesit të respektojnë mund të gjenden në faqen e internetit të Këshillit Britanik (<https://www.britishcouncil.org/organisation/transparency/policies>).

2.3 Kushtet e Përgjithshme të Ofertës ("Kushtet e Ofertës ")

2.3.1 Zbatimi i Kushteve të Ofertes të kësaj Kërkesë– Duke marrë pjesë në këtë Proces Prokurimi dhe/ose duke paraqitur një **Ofertë**, konsiderohet se ju pranoni dhe do të pranoni të gjitha dispozitat e kësaj Kërkesë për **Ofertë** dhe të Shtojcave të saj. Prandaj, **Ofertë/Propozimet** duhet të bëhen bazuar dhe në përputhje me kërkesat e kësaj Kërkesë për **Ofertë**.

2.3.2 Verifikime nga palë të treta – Oferta juaj paraqitet në bazë të miratimit tuaj për të lejuar Këshillin Britanik të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për të verifikuar informacionin që keni dhënë, dhe për të lejuar analizën e Ofertës tuaj të bëhet nga një ose më shumë palë të treta të përcaktuara nga Këshilli Britanik për këto qëllime.

2.3.3 Informacioni i dhënë për furnizuesit potencial – Informacioni i dhënë si pjesë e këtij Procesi të Prokurimit jepet në besim të mirë. Informacioni i përfshirë në Kërkesën për Ofertim (RFP), dokumentet mbështetëse dhe në çdo komunikim të shkruar ose oral të lidhur me të besohet se është i saktë në kohën e lëshimit. Nuk pranohet përgjegjësi (me përjashtim të përfaqësimit të rremë) për saktësinë, përshtatshmërinë ose plotësinë e tij dhe asnjë garanci nuk jepet në këtë drejtim.

2.3.4 Furnizuesit potencialë duhet të bëjnë hetimet e tyre– Ju jeni përgjegjës për analizimin dhe shqyrtimin e të gjithë informacionit që ju jepet si pjesë e këtij Procesi të Prokurimit dhe për të formuar mendimet tuaja dhe për të kërkuar këshillën e duhur në mënyrën që ju e konsideroni të përshtatshme. Procesi i qartësimit i përcaktuar në paragrafin 12 duhet të përdoret për çdo pyetje lidhur me këtë Proces Prokurimi.

2.3.5 Ndryshimet në Kërkesën për Ofertë – Në çdo kohë para afatit të përgjigjes, Këshilli Britanik mund të ndryshojë Kërkesën për Ofertë dhe nëse është e nevojshme, Afati i Përgjigjes do të zgjatet në dispozicion të Këshillit Britanik, sipas kushteve të tyre.

2.3.6 Pajtueshmëria e Ofertes – Çdo mall dhe/ose shërbim i ofruar duhet të bazohet dhe të jetë në përputhje me Kërkesën për ofertë (përfshirë, pa kufizim, çdo specifikim i kërkesave të Këshillit Britanik, Kushtet e Ofertës dhe Kontratën) dhe të gjitha dokumentet tjera dhe çdo përpjekje ose përditësim që lëshohen nga Këshilli Britanik si pjesë e këtij Procesi të Prokurimit.

2.3.7 Pajtueshmëria me kushtet e Kontratës – Furnizuesi i suksesshëm duhet të përputhet me Kontratën siç është përcaktuar në Aneksin 1 pa asnjë ndryshim (me përjashtim sic përshkruhet në paragrafin 3.1.4)

2.3.8 Formati i Ofertës - Oferta duhet të përfshijë dokumentet relevante siç janë detajuar nga Këshilli Britanik në Aneksin 2 (Propozimi i Furnizuesit), të plotësuara në përputhje me të gjitha udhëzimet relevante. Çdo dokument i kërkuar nga Këshilli Britanik duhet të plotësohet në tërësi. Është e rëndësishme që të lexoni me kujdes Kërkesën për Propozim para se të plotësoni dhe paraqisni Propozimin tuaj.

2.3.9 Modifikimet në Propozimet pas paraqitjes së tyre – Ju mund të modifikoni Propozimin tuaj para Afatit të Përgjigjes duke dhënë njoftim të shkruar Këshilli Britanik. Çdo modifikim duhet të jetë i qartë dhe të paraqitet si një Ofertë krejtësisht e ri në përputhje me Aneksin 2 (Propozimi i Furnizuesit) dhe Kushtet e Ofertës.

2.3.10 Përrjashtimi – Nëse shkëlni këto Kushte të Ofertës, nëse ka gabime, neglizhenca ose ndryshime të rëndësishme të dëmshme lidhur me çdo informacion të dhënë nga ju në çdo fazë të këtij Procesi të Prokurimit, nëse ka ndonjë rrethanë tjetër e përcaktuar në këtë RFP dhe/ose në dokumentet mbështetëse, që i lejon Këshillit Britanik të refuzojë një Ofertë dhe/ose nëse ju ose këshilltarët tuaj të emëruar përrpiqeni:

- të ndikoni në mënyrë të papërshtatshme në këtë Proces Prokurimi ose të caktoni ose vendosni çmimin e mallrave ose shërbimeve;
- të hyrni në një marrëveshje me çdo palë tjetër që ajo palë të refuzojë të paraqesë një Ofertë;
- të hyni në ndonjë marrëveshje me çdo palë tjetër (përveç një palë tjetër që bën pjesë në ofertën tuaj të konsorciumit ose është nënkontraktori i propozuar nga ju) në lidhje me çmimet e paraqitura;
- të bashkëpunoni në ndonjë mënyrë tjetër;
- të angazhoheni në ryshfet të drejtpërdrejtë ose të jodrejtpërdrejtë, ose lobim nga ju ose këshilltarët e emëruar në lidhje me këtë Proces Prokurimi; ose
- për të marrë informacion nga ndonjë nga punonjësit, agjentët ose këshilltarët e Këshilli Britanik në lidhje me këtë Proces Prokurimi (përveç siç është përcaktuar në Kushtet e ofertës) ose nga një furnizues potencial tjetër ose një Ofertë tjetër,

Këshilli Britanik ka të drejtë të refuzojë Ofertën tuaj në tërësi dhe të t'ju përrjashtojë nga ky Proces Prokurimi. Në përrputhje me paragrafin 3.3.1 më poshtë, duke marrë pjesë në këtë Proces Prokurimi, ju pranoni se Këshilli Britanik nuk ka asnjë përrgjegjësi për një furnizues potencial të përrjashtuar në këto rrethana.

British Council do të lajmërojë vetëm Entitetin e sukseshëm të veleresimin e këtij prokurimi.

2.3.11 Kostot e Ofertës – Ju jeni përrgjegjës për të marrë të gjitha informacionet e nevojshme për përrgatitjen e Ofertës tuaj dhe për të gjitha kostot dhe shpenzimet e pësuar në përrgatitjen e Ofertës. Në përrputhje me paragrafin 3.3.15, ju pranoni duke marrë pjesë në këtë Proces Prokurimi, duke përrfshirë pa kufizim paraqitjen e një Ofertë, që nuk keni të drejtë të kërkoni nga Këshilli Britanik asnjë shpenzim ose përrgjegjësi që mund të përrsoni në paraqitjen e një ofertë, pavarësisht nëse Oferta juaj është e sukseshme apo jo.

2.3.12 Të drejtat për të anuluar ose ndryshuar këtë proces prokurimi – Asgjë në këtë proces prokurimi nuk do ta detyrojë Këshillin Britanik të hyjë në ndonjë marrëveshje kontraktuale ose tjetër me ju ose ndonjë furnizues tjetër të mundshëm. Synohet që pjesa e mbetur e këtij procesi të prokurimit të zhvillohet në përrputhje me dispozitat e kësaj RFP-je, por Këshilli Britanik rezervon të drejtën të përrfundojë ose të ndryshojë (për të përrfshirë, pa kufizim, në lidhje me do afat kohor) këtë proces prokurimi me njoftim me shkrim. Në varësi të paragrafit 3.3.15, Këshilli Britanik nuk do të ketë asnjë përrgjegjësi për humbjet, kostot ose shpenzimet që ju përrsoni si rezultat i veprimeve të tilla.

2.3.13 Anëtarët dhe nënkontraktorët e konsorciumit – Është përrgjegjësia juaj të siguronit që çdo personel, anëtarë konsorciumi, nënkontraktorë dhe këshilltarë të respektojnë këto Kushte të Ofertës dhe kërkesat e kësaj RFP.

2.3.14 Përgjegjësia – Asgjë në këto kushte të propozimit nuk synon të përjashtojë ose kufizojë përgjegjësinë e Këshillit Britanik në lidhje me mashtrimin ose në rrethana të tjera ku përgjegjësia e Këshillit Britanik mund të mos kufizohet sipas ndonjë ligji në fuqi.

3 Konfidencialiteti dhe ndarja e informacionit

3.1 Të gjitha informacionet e dhëna nga Këshilli Britanik, duke përfshirë këtë RFP dhe të gjitha dokumentet e tjera në lidhje me këtë proces prokurimi, me shkrim ose me gojë, duhet të trajtohen në konfidencë dhe të mos i zbulohen asnjë pale të tretë (me përjashtim të këshilltarëve tuaj profesionistë, konsorciumit anëtarët dhe/ose nënkontraktorët vetëm për qëllime që t'ju ndihmojnë të merrni pjesë në këtë proces prokurimi dhe/ose të përgatitni ofertën tuaj), përveç rasteve kur informacioni është tashmë në domenin publik ose kërkohet të zbulohet sipas ndonjë ligji në fuqi.

3.2 Ju nuk duhet të zbuloni, kopjoni ose riprodhoni asnjë nga informacionet që ju janë dhënë si pjesë e këtij procesi të prokurimit, përveçse për qëllimet e përgatitjes dhe dorëzimit të një Ofertë. Nuk duhet të ketë asnjë publicitet nga ana juaj në lidhje me Procesin e Prokurimit ose dhënien e ardhshme të ndonjë kontrate, përveç nëse Këshilli Britanik ka dhënë pëlqimin shprehimisht me shkrim për komunikimin përkatës.

3.3 Këshilli Britanik rezervon të drejtën t'i zbulojë të gjitha dokumentet në lidhje me këtë proces prokurimi, duke përfshirë pa kufizim Ofertën tuaj, çdo punonjësi, agjenti të palës së tretë, këshilltari ose palë tjetër e tretë e përfshirë në Procesin e Prokurimit në mbështetje dhe/ose në bashkëpunim me Këshillin Britanik. Këshilli Britanik rezervon më tej të drejtën të publikojë kontratën pasi të jetë dhënë dhe/ose të zbulojë informacion në lidhje me performancën e furnizuesit sipas kontratës në përputhje me çdo politikë transparence të sektorit publik (siç përmendet më poshtë). Duke marrë pjesë në këtë proces prokurimi, ju pranoni një zbulim të tillë dhe/ose publikim nga Këshilli Britanik në përputhje me këto të drejta të rezervuara prej tij sipas këtij paragrafi.

3.4 Akti i Lirisë së Informacionit 2000 ("FOIA"), Rregullorja e Përgjithshme e BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR) 2015, Rregulloret e Informacionit Mjedisor 2004 ("EIR") dhe politikat e transparencës së sektorit publik zbatohen për Këshillin Britanik (së bashku "**Detyrimet e zbulimit**").

3.5 Ju duhet të jeni të vetëdijshëm për detyrimet dhe përgjegjësitë e Këshillit Britanik sipas Detyrimeve të Zbulimit për të zbuluar informacionin e mbajtur nga Këshilli Britanik. Informacioni i dhënë nga ju në lidhje me këtë proces prokurimi, ose me ndonjë kontratë që mund të fitohet si rezultat i këtij ushtrimi, mund të duhet të zbulohet nga Këshilli Britanik në bazë të Detyrimeve për Zbulimin, përveç nëse Këshilli Britanik vendos të zbatojë përjashtimet ligjore sipas FOIA ose EIR.

4 Vlefshmëria e Ofertimit

4.1 Oferta juaj duhet të mbetet i hapur për pranim nga Këshilli Britanik për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh nga Afati i Përgjigjes. Një ofertë e pavlefshme për këtë periudhë mund të refuzohet nga Këshilli Britanik.

5 Pagesa dhe Faturimi

5.1 Limiti i buxhetit për këtë shërbim është deri në 30,000 GBP, përfshirë TVSH-në, tarifat dhe taksat.

5.2 Këshilli Britanik do të paguajë faturat e adresuara dhe të padiskutueshme (shoqëruar me dokumentacionin përkatës) brenda 30 ditëve në përputhje me kërkesat e Kontratës. Furnizuesi për Këshillin Britanik duhet të sigurojë që dispozitat e krahasueshme të pagesës të zbatohen për pagesën e nënkontraktorëve të tyre dhe të nënkontraktorët e nënkontraktorëve të tyre.

Pagesa e kontratës do të disbursohet me këste, sipas kalendarit të aktiviteteve për të cilat do të dakordësohen në kontate.

Pagesat do të bëhen duke përdorur kursin e këmbimit të Këshillit Britanik, e cila është fikse në nivel mujor.

6 Specifikime

Këshilli Britanik në Shqipëri dëshiron të kërkojë një Ofertë për prodhimin e një videodokumentari me cilësi të lartë mbi migrimin e paligjshëm, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe përmirësimin e cilësisë së informacionit mbi kompleksitetin dhe natyrën e shumëanshme të migracionit të paligjshëm, shkaqet dhe pasojat e tij. Duke theksuar implikimet e saj socio-ekonomike, kulturore dhe politike, ne kërkojmë të kundërshtojmë keqperceptimet dhe narrativat ekzistuese dezinformative mbi këtë temë. Projekti synon të zbulojë dhe rrëfejë realitetet me të cilat përballen emigrantët, duke vënë në pah betejat e tyre dhe ndikimin në familjet dhe komunitetet e tyre, me fokus të veçantë në veri të Shqipërisë.

Objektivat specifike:

- Për të nërgjegjësuar dhe edukuar publikun e gjerë, politikëbërësit dhe palët e interesuara rreth realiteteve të nuancuara të migracionit të paligjshëm, ky dokumentar synon të kapërcejë stereotipet e zakonshme dhe narrativat e thjeshta. Ai do të shërbejë si një platformë arsimore, duke u thelluar në kompleksitetin e migracionit të paligjshëm, duke përfshirë shtytësit e tij socio-ekonomikë, kornizat ligjore dhe aspektet humanitare.
- Për të ofruar dëshmi, të dhëna dhe fakte që detajojnë shkaqet dhe pasojat e migrimit të paligjshëm, dokumentari do të shfaqë të dhëna të mbledhura dhe analiza mbi fenomenin, duke eksploruar arsyet e tij sociale, ekonomike, kulturore dhe politike. Ai do të paraqesë përfitimet dhe rreziqet e perceptuara kundrejt atyre realiste, ndikimin tek vetë emigrantët, si dhe tek familjet e tyre dhe komunitetet lokale, duke u fokusuar në Shqipërinë e Veriut.
- Të përfshijë histori dhe dëshmi të fuqishme nga jeta reale nga migrantët (emigrantë të ligjshëm dhe të paligjshëm) nga veriu i Shqipërisë, të cilët kanë përvojë të drejtpërdrejtë të udhëtimit dhe sfidave të tij, duke ofruar një këndvështrim personal mbi vështirësitë dhe shpresat që përcaktojnë përvojat e tyre.
- Për të eksploruar dhe paraqitur modele dhe mundësi alternative të disponueshme brenda vendit, duke shfaqur modele të suksesshme integruese dhe qasje politikash që kanë potencial për të zbutur shtytësit sfidues të migrimit të paligjshëm.
- Për të paraqitur shembuj të migrimit të rregullt, legal, duke përfshirë migrimin qarkullues nëse është e mundur.

Metodologjia:

Dokumentari do të gërmojë në arsyet e migrimit të paligjshëm, duke shqyrtuar ndikimin e tij tek migrantët, familjet e tyre dhe komunitetet lokale, duke eksploruar gjithashtu modele dhe mundësi alternative brenda vendit. Ai do të përfshijë këndvështrime nga migrantët dhe/ose familjet dhe miqtë e tyre për të pasuruar kontekstin dhe për të shpjeguar fenomenet nga perspektiva e dorës së parë. I drejtuar publikut të gjerë, politikëbërësve dhe palëve të interesuara të përfshira në çështjet e migracionit, dokumentari do të jetë afërsisht 45 deri në 60 minuta. I prezantuar në gjuhën shqipe me titra në anglisht, ai do të shfaqë një ritëm dinamik duke përdorur pamje vizuale dhe intervista jo vetëm për të informuar, por edhe për të ndikuar emocionalisht shikuesit dhe për të nxitur reflektim. Duhet të frymëzojë edhe me modelet pozitive dhe të shkaktojë reagim.

Për këtë arsye, një kompani profesionale e prodhimit të dokumentarëve do të kontraktohet për të zhvilluar fillimisht konceptin dhe skenarin në bashkëpunim të ngushtë me "Ekipin e Projektit të Rrugëve Alternative", dhe më pas do të prodhojë dokumentarin, duke siguruar një prezantim të balancuar dhe me ndikim, të përshtatur për një kombëtare dhe audiencë ndërkombëtare.

Aktivitetet dhe produktet kryesore:

- **Zhvillimi i skenarit:** Zhvillimi i konceptit dhe skenarit në bashkëpunim të ngushtë me Ekipin e Rrugës Alternative (AP) për të siguruar që ai të përputhet me objektivat e projektit.
- **Intervistat dhe tregimet:** Identifikoni individët që do të intervistohen dhe mblidhni fakte, të dhëna dhe histori të jetës reale, duke përfshirë dëshmi nga migrantët, legalë dhe ilegalë, me origjinë nga Shqipëria e Veriut, të kaluar dhe/ose aktual, familjet dhe miqtë e tyre, duke përfshirë udhëtimin ndërkombëtar nëse është e mundur dhe e rëndësishme.
- **Prodhimi i draftit të parë:** Prodhoni draftin fillestar të dokumentarit dhe ia dorëzoni ekipit të AP për komente.
- **Rrëfimi dhe Titra:** Dokumentari do të jetë në gjuhën shqipe me titra në anglisht; përkthimi do të jetë përgjegjësi e ofruesit të shërbimit.
- **Të drejtat dhe lejet:**
 - a) Merrni të drejta të plota të përdorimit të muzikës dhe elementëve të tjerë grafikë.
 - b) Sigurimi i lejeve të nevojshme për filmimin e të miturve dhe grupeve të tjera vulnerabël.
- **Versioni përfundimtar:** Jepni një kopje përfundimtare të dokumentarit, duke u siguruar që të mos i kalojë 60 minutat. Versioni përfundimtar do të jetë me cilësi transmetimi me definicion të lartë, audio me cilësi të lartë, i përshtatshëm për kinema, TV dhe platforma të mediave sociale.
- Organizoni së bashku me ekipin e Alternative Pathways shfaqjet publike të filmave (në veri të Shqipërisë, si dhe në Tiranë)

7 Kërkesat / Kufizimet e Detyrueshme

7.1 Si pjesë e Propozimit/Ofertës tuaj, ju duhet të konfirmoni që përmbushni kërkesat/kufizimet e detyrueshme, nëse ka, siç përcaktohet në specifikimet e Këshillit Britanik që është pjesë e kësaj RFP. Mosrespektimi i ndonjë kërkesë ose kufizimi të detyrueshëm do t'i japë të drejtë Këshillit Britanik të refuzojë një Propozim.

Kualifikimet dhe përvojat e kërkuara të ofruesit të shërbimit

Furnizuesit e mundshëm duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Të jetë i regjistruar si person juridik, dhe të ushtrojë veprimtari në territorin e Shqipërisë.
- Të paktën 5 vjet përvojë pune në një fushë të ngjashme;
- Kapacitetet dhe burimet teknike për të siguruar produkte me cilësi të lartë;
- Njohuri dhe kuptim të mirë të kontekstit dhe situatës socio-ekonomike dhe kulturore të Shqipërisë së Veriut.

8 Dokumentet shtojcë

8.1 Dokumentet/informacionet e mëtejshme mund t'u ofrohen furnitorëve të mundshëm si aneksi i kësaj RFP dhe/ose nëpërmjet lëshimit të dokumenteve/lidhjeve shtesë për informacione/dokumente shtesë. Ju lutemi shikoni listën e shtojcave në fund të këtij dokumenti.

9 Afatet kohore

9.1 Në varësi të çdo ndryshimi të njoftuar furnizuesve të mundshëm nga Këshilli Britanik në përputhje me Kushtet e Ofertës, afatet kohore të synuara të zbatueshme për këtë proces prokurimi janë:

Aktiviteti	Data / Koha
RFP dërguar për furnizuesit që ofrojnë të konkurrojnë	30.07.2024
Afati për pyetje nga furnizuesit potencialë	05.08.2024, 17.00
Afati për përgjigje nga Këshilli Britanik	09.08.2024
Afati për dorëzimin e Ofertave nga furnizuesit potencialë (Afati i Përgjigjes)	26.08.2024, 14.00
Vendimi final	02.09.2024
Nënshkrimi i kontratës me furnizuesin	12.09.2024
Data e fillimit të kontratës	16.09.2024

10 Udhëzime për përgjigje

10.1 Dokumentet që duhet të dorëzohen për të formuar Propozimin/Ofertë tuaj, janë të renditura në Pjesën 2 (**Dorëzimi i Listës kontrolluese**) e Shtojcës 2 (**Propozimi i Furnizuesit**) të kësaj RFP. Të gjitha dokumentet e kërkuara si pjesë e Ofertës tuaj duhet të dorëzohet në Portalin In-Tend në linkun e mëposhtëm: <https://in-tendhost.co.uk/britishcouncil/asp/Home> dhe aksesoni thirrjen përmes këtij numri të Referencës: **BC/03559** deri më 26 gusht 2024, siç përcaktohet në seksionin Afatet Kohore.

Kërkesat e mëposhtme duhet të respektohen kur dorëzoni Ofertën tuaj në përgjigje të kësaj RFP:

- Ju lutemi sigurohuni që ta dërgoni parashtrësën tuaj në kohën e duhur për të parandaluar problemet me teknologjinë – Ofertat e vonuara mund të refuzohen nga Këshilli Britanik.
- Formatet PDF, JPG, PPT, Word dhe Excel mund të përdoren për çdo dokumentacion shtesë mbështetës.
- Të gjitha bashkëngjitjet/dokumentacioni mbështetës duhet të jepen veçmas në dokumentin tuaj kryesor të Ofertës, të etiketuar qartë dhe të ndërlidhen me Oferten si relevante.
- Nëse dorëzoni një politikë/dokument të përgjithshëm, duhet të tregoni referencën e faqes dhe paragrafit që është e rëndësishme për një pjesë të veçantë të Ofertës tuaj.
- Përveç rasteve kur shprehet ndryshe si pjesë e kësaj RFP ose Shtojcave të saj, të gjitha Ofertat duhet të jenë në formatin e kërkesës përkatëse të Këshillit Britanik me përgjigjen tuaj ndaj asaj kërkesë të futur më poshtë.
- Kur provat mbështetëse kërkohen si 'ose ekuivalente' ju duhet të demonstroi një ekuivalencë të tillë si pjesë e Ofertës tuaj.

11 Kërkesa për sqarim

11.1 Të gjitha kërkesat për sqarime duhet të dorëzohen përmes emailit emarilda.leti@britishcouncil.org ose personalisht në Adresën e Këshillit Britanik: **RR. Sami Frasheri, Pall. TeknoProjekt, Hyrja 2, Ap.3, Tiranë, Shqipëri**, deri në Afatin e Sqarimit, siç përcaktohet në seksionin Afatet kohore të kësaj RFP. Këshilli Britanik nuk ka asnjë detyrim për t'iu përgjigjur kërkesave për sqarime dhe do të përgjigjet nëse pyetja është e përshtatshme dhe e marrë përpara Afatit të Sqarimit.

11.2 Çdo kërkesë për sqarim duhet t'i referohet qartë paragrafit përkatës në dokumentacionin e RFP-së dhe, për aq sa është e mundur, duhet të grumbullohen kërkesat për sqarim dhe jo të dërgohen veçmas.

11.3 Këshilli Britanik rezervon të drejtën për të lëshuar çdo kërkesë sqarimi të bërë nga ju, dhe përgjigjen, për të gjithë furnizuesit e mundshëm, përveç rastit kur ju kërkoni shprehimisht që ajo të mbahet konfidenciale në kohën kur bëhet kërkesa. Nëse Këshilli Britanik konsideron se përmbajtja e kërkesës nuk është konfidenciale, ai do t'ju informojë dhe ju do të keni mundësinë të tërhiqni pyetjen e sqarimit përpara se Këshilli Britanik t'u përgjigjet të gjithë furnizuesve të mundshëm.

11.4 Këshilli Britanik në çdo kohë mund të kërkojë informacion të mëtejshëm nga furnitorët e mundshëm për të verifikuar ose sqaruar çdo aspekt të ofertës të tyre ose informacion tjetër që ata mund të kenë dhënë. Nëse nuk i jepni Këshillit Britanik informacione ose sqarime shtesë brenda çdo afati të njoftuar për ju, oferta juaj mund të refuzohet plotësisht dhe ju mund të skualifikoheni nga ky proces prokurimi

12 Kriteret e Vlerësimit

12.1 Oferta juaj do të vlerësohet si më poshtë:

Faza 1: Oferta do të kontrollohen për t'u siguruar që ato janë plotësuar në mënyrë korrekte dhe se i gjithë informacioni i nevojshëm është dhënë, përgjigjet e plotësuar saktë me të gjitha informacionet përkatëse që janë dhënë dhe të gjitha kërkesat e detyrueshme siç janë plotësuar në seksionin 8 do të

vazhdojnë në Fazën 2. Çdo Ofertë të paplotësuar saktë në përputhje me kërkesat e kësaj RFP dhe/ose që përmbajnë lëshime mund të refuzohen në këtë pikë. Kur një Ofertë refuzohet në këtë pikë, ai automatikisht do të skualifikohet dhe nuk do të vlerësohet më tej.



Faza 2: Nëse një ofertues arrin të kalojë Fazën 1 të vlerësimit, atëherë oferta e tij do të vlerësohet në përputhje me metodologjinë e vlerësimit të përcaktuar më poshtë.

13.2 Kriteret për të fituar – Përgjigjet nga furnitorët e mundshëm do të vlerësohen për të përcaktuar më shumë oferta ka avantazhe ekonomike duke përdorur kriteret dhe vlerat e mëposhtme dhe do të vlerësohet tërësisht në përgjigjen tuaj të paraqitur:

Kriteri	Pesha
Vlerat Shoqërore	10%
Cilësia e propozimit (metodologjia dhe qasja)	25%
Përvoja dhe ekspertiza/kualifikimi i ofertuesit dhe ekipit të punës	25%
Parimi tregtar - efektiviteti i kostos	40%

12.3 Modeli i pikëzimit – Oferta do t'i nënshtrohen një shqyrtimi fillestar në fillim të Fazës 2 të procesit të vlerësimit. Çdo ofertë që nuk plotëson kërkesat ose kufizimet e detyrueshme (nëse ka) do të refuzohet plotësisht në këtë pikë dhe nuk do të vlerësohet ose vlerësohet më tej. Ofertat që nuk janë refuzuar do të vlerësohen nga një panel vlerësimi i caktuar nga Këshilli Britanik për të gjitha kriteret e ndryshme nga ato komerciale duke përdorur modelin e mëposhtëm të pikëzimit:

Pikët	Interpretimi
9-10	E shkëlqyeshme – Në përgjithësi, përgjigja tregon se ofertuesi plotëson të gjitha fushat e kërkesës dhe ofron të gjitha provat e fushave të kërkuara në nivelin e detajeve të kërkuara. Kjo, pra, është një përgjigje e detajuar e shkëlqyer që plotëson të gjitha aspektet e kërkesës duke mos lënë paqartësi nëse ofertuesi mund të përmbushë kërkesën
6-8	E mirë – Në përgjithësi, përgjigja tregon se ofertuesi plotëson të gjitha fushat e kërkesës dhe ofron të gjitha fushat e provave të kërkuara, por përmban disa lëshime të parëndësishme në lidhje me nivelin e detajeve të kërkuara për sa i përket përgjigjes ose provave. Prandaj, kjo është një përgjigje e mirë që plotëson të gjitha aspektet e kërkesës vetëm me një paqartësi të parëndësishme për shkak të dështimit të ofertuesve për të ofruar të gjithë informacionin në nivelin e detajeve të kërkuara.
4-5	E përshtatshme – Në përgjithësi përgjigja tregon se ofertuesi i plotëson të gjitha fushat e kërkesës, por jo të gjitha fushat e provave të kërkuara janë ofruar. Prandaj, kjo është një përgjigje adekuate, por me disa paqartësi të kufizuara nëse ofertuesi mund të përmbushë kërkesat për shkak të dështimit të ofertuesit për të ofruar të gjitha provat e kërkuara.
1-3	Dobët – Përgjigja nuk tregon se ofertuesi plotëson kërkesat në një ose më shumë fusha. Prandaj, kjo është një përgjigje e dobët me paqartësi të konsiderueshme nëse ofertuesi mund të

	përmbushë kërkesën për shkak të dështimit të ofertuesit për të treguar se plotëson një ose më shumë fusha të kërkesës.
0	E papranueshme – Përgjigja nuk është në përputhje me kërkesat e RFP-së dhe/ose nuk është dhënë asnjë përgjigje.

12.4 Vlerësimi tregtar – “Çmimi i përgjithshëm” i propozuar (siç llogaritet në përputhje me kërkesat e Aneksit 3 (Buxheti) për mallrat dhe/ose shërbimet do të vlerësohet nga paneli i vlerësimit për qëllimet e vlerësimit tregtar, informacione të mëtejshme mbi këtë qasje mund të gjeni në Shtojcën 3. Në rast se çdo çmim shprehet si subjekt i ndonjë çmimi të supozuar, kualifikimi ose indeksimi që nuk parashikohet nga Këshilli Britanik si pjesë e buxhetit të propozuar, Këshilli Britanik mund të refuzojë ofertën e plotë në këtë pikë. Këshilli Britanik mund të refuzojë gjithashtu çdo Ofertë ku Çmimi i Përgjithshëm për mallrat dhe/ose shërbimet konsiderohet nga Këshilli Britanik si anormalisht i ulët pas proceseve përkatëse të përcaktuara sipas rregullave të prokurimit i jepet Propozimit që ofron “Çmimin e përgjithshëm” më të ulët.

12.5 Moderimi dhe aplikimi i peshës për secilin kriter – Paneli vlerësues i caktuar për këtë proces të prokurimit do të takohet për të rënë dakord dhe për të moderuar pikët për secilin kriter të dhënies. Pikët përfundimtare për sa i përket përqindjes së rezultatit të përgjithshëm të ofertës do të merren duke aplikuar faktorët përkatës të peshës së përcaktuar si pjesë e tabelës së kriterëve të dhënies së çmimit më sipër. Pikët e përqindjes për çdo kriter çmimi do të bashkohen për të dhënë një pikë përqindje prej 100.

12.6 Oferta(t) fitues - Një Marrëveshje Kontrate do t'i jepet furnizuesit potencial, oferta e të cilit shënon pikën më të lartë të përqindjes prej 100 kur zbaton metodologjinë e mësipërme të vlerësimit, e cila gjithashtu mbështetet nga çdo dëshmi verifikimi e kërkuar (të përfshijë, pa kufizime, çdo informacion të përditësuar) i marrë nga Autoriteti në lidhje me çdo vetëcertifikim ose kërkesa të tjera të referuara në çdo kohë në këtë proces prokurimi. Rregullime të mëtejshme për ofertën dhe buxhetin origjinal mund të kërkojnë nga furnizuesi i suksesshëm, sipas nevojave dhe prioriteteve të Këshillit Britanik dhe të Projektit, përpara nënshkrimit të kontratës.